



Pranimi / Determiat Pranimi / Determiat Received / Determiat	24. 11 2021	1	viti god year
Organ / Rjeshtja Organ / Rjeshtja Org / Dect	In Proct In Proct Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	5653/2021		1/161



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.839/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti -anëtar dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.893/2021 të datës 30.09.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë rruga Xhamia fshati Doberqan në Komunën e Gjilanit, kundër Vendimit me Nr.1173/2021 të datës 03.09.2021 të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshëm, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 24.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.839/2021 e datës 30.09.2021, e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet** Vendimi me Nr.1173/2021/2021 i datës 03.09.2021 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe lënda kthehet në rivendosje të organi i njëjtë i cili e ka nxjerr aktin administrativ.
- III. Detyrohet** Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që brenda afatit prej 15 ditësh, të ndërmarr veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 30.09.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4846/2021 të regjistruar me numër A.nr.839/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1179/02 të datës 03.09.2021 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë. Këshilli me datën 12.10.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4846/2021 të regjistruar me numër A.nr.839/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e datës 03.09.2021 me numër të protokollit 1173 për emërimin e nëpunësit civil në pozitën e kategorisë se mesme drejtuese; Kërkesën e datës 16.09.2021 me numër të protokollit 1216 për shqyrtimin të vendimit; Kërkesën e datës 21.09.2021; Emalin e datës 01.10.2021; Emalin e datës 29.09.2021; Kërkesën e datës 29.09.2021 me numër të protokollit 2456 drejtuar DMZP-se; Vendimin e datës 03.09.2021 me numër të protokollit 1173; Emalin e datës 14.10.2021 me numër të protokollit 5030/2021; Njoftimin e datës 13.10.2021 me numër të protokollit 1057; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.10.2021 me numër të protokollit 4905/2021; Përgjigjen në ankesë të datës 12.10.2021 me numër të protokollit 4990/2021; Vendimin e datës 17.04.2015 nr.04/24; Vendimin e datës 05.06.2018 me numër 10/50; Emalin e datës 01.11.2021; Emalin e datës 02.11.2021 me numër të protokollit 523/2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rivendosje, *sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se ankuesja sipas Vendimit Nr.04/24 të datës 17.04.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës ka qenë e emëruar në pozitën e punës Drejtoreshë e Përgjithshme e Institutit të Kosovës për Administratë Publike, me mandat tre (3) vjeçar. Të njëjtës me Vendimin Nr.10/50 të datës 05.06.2018, i është vazhduar mandati edhe për tri (3) vite.

Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, pas përfundimit të mandatit të dytë të ankueses, me datë 03.09.2021 ka nxjerr Vendimin Nr.1179/02 përmes të cilit ankuesen e ka emëruar në pozitë të mesme drejtuese, respektivisht në pozitën e Drejtorit të Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, me lokacion në Stantërg - Mitrovicë.

Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, përmes shkresës me numër protokollit 2456 të datës 29.09.2021, i është drejtuar Drejtorit të DMZP-së, duke kërkuar anulimin e Vendimit Nr.1179/02 të datës 03.09.2021, me arsyetimin se kandidatja e emëruar, gjegjësisht ankuesja nuk posedon përgatitjen e duhur profesionale, përvojën, aftësitë dhe shkathtësitë për pozitën të cilën

është emëruar. I njëjti ketë arsytim e mbështet në detyrat dhe përgjegjësit e institucionit të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, dhe përshkrimin e detyrave të punës të miratuar nga Ministria e Administratës Publike.

Ndërsa, ankuesja me datë 30.09.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1179/02 të datës 03.09.2021 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, me pretendimin ankimor se e njëjta me rastin e sistemimit është diskriminuar për shkak të gjinisë dhe përkatësisë së komunitetit turk, sepse sipas të njëjtës vendi i punës ku është sistemuar, në Stantërg - Mitrovicë është me tepër se 200 km (vajtje ardhje), nga vendbanimi i saj, gjegjësisht nga Gjilani në Mitrovicë. Po ashtu ankuesja pretendon se në kohën e sistemimit ka pasur disa vende të lira të kategorisë së mesme drejtuese të cilat i janë përgjigjur distancës fizike por edhe përvojës dhe përgatitjes profesionale të saj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, ka shqyrtuar Vendimin Nr.1179/02 të datës 03.09.2021 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, dhe si rrjedhojë ka gjetur se vendimi për emërimin e ankueses në pozitën e Drejtorit të Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve, në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, me lokacion në Stantërg - Mitrovicë, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.6, ku përcaktohet se: 1. *Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.3 shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.* Vendimi në fjalë, në arsyetimin e tij përmban vetëm bazën ligjore mbi të cilën është nxjerr vendimi, dhe një përshkrim të gjendjes faktike se: *Pozita e Drejtor i Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Minerave në Trepçë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë të lartpërmendurës i ofrohet në bazë të konfirmimit të pozitës së lirë nga Ministria e Ekonomisë dhe përgatitjes së saj profesionale, përvojës së punës së kaluar në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, mirëpo i njëjti vendim nuk përmban faktet vendimtare si: Përgatitjen profesionale të ankueses dhe kriteret të cilat kërkohen për pozitën përkatëse të emërimit, si dhe përvojën e punës të ankueses dhe arsyen pse kjo përvojë është adekuate në rastin konkret. Rrjedhimisht, arsyetimi i vendimit nuk përmban përshkrimin rreth përshtatshmërisë së ankueses për pozitën përkatëse e cila do t'i siguronte palës mundësinë që ta kuptonte aktin administrativ. Po ashtu, vendimi i kontestuar nuk përmban një shpjegim të gjendjes faktike, nëse në kohën e emërimit të ankueses ka qenë vetëm kjo pozitë e lirë, apo ka pasur me shume pozita të lira por emërimi është bërë sipas diskrecionit të Drejtorit të DMZP-së, dhe nëse është ushtruar diskrecioni, mungon shpjegimi se pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë si në vendim.*

Kolegji vlerëson se të metat e tilla të aktit administrativ e bëjnë të paligjshëm Vendimin Nr.1179/02 të datës 03.09.2021 të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si rezultat i kësaj nuk ka qenë i mundur trajtimi i ligjshmërisë së pretendimeve ankimore dhe vendosjes në mënyrë meritore lidhur me ankesën, kështu që duke u bazuar në neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që lënda të kthehet në rivendosje të organi i njëjtë, gjegjësisht Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.



Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, në procedurë të rivendosjes, duhet t'i marr parasysh pikëpamjet juridike të këtij vendimi dhe t'i eliminojë të metat e konstatuara të aktit administrativ.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.839/2021

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë në MPB;
- Drejtorit të Përgjithshëm të SHGJK-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

